

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.nr.285/10

9 nëntor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Pejë me Trupin Gjykues të përbërë nga Gjykatësi Ingo Risch në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues, Gjykatësi Gunnar Oyhaugen dhe Gjykatësi Salih Berisha si anëtarë të Trupit Gjykues dhe proces-mbajtës Robina Struthers në lëndën penale kundër **Vukmir CVETKOVIĆ** (më tutje si "i pandehur") i akuzuar sipas aktakuzës numër PPS 18/09, të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) më 15 shtator 2010 për kryerjen e veprave penale si në vijim:

*Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me Nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KPRSFJ) sepse në kundërshtim me Nenin 3 i përbashkët me konventat katër të Gjenevës më 12 gusht 1949 dhe Nenet 1 dhe 17 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, si dhe Konventave 1949 të Gjenevës, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante ndaj akuzës aktuale, i pandehuri, duke vepruar së bashku me anëtarë të policisë serbe dhe në uniformë me dhunë zhvendosi popullsinë civile shqiptare të Klinës duke urdhëruar të paktën një herë nën kërcënim të armës fshatarët që menjëherë të lirojnë shtëpitë e tyre dhe të largohen nga fshati dhe duke u vënë zjarrin të paktën dy shtëpive në **Klinë në fund të marsit 1999**.*

Pas mbajtjes së gjykimit të hapur për publikun më 26 tetor, 27 tetor dhe 28 tetor 2010 si dhe më 9 nëntor 2010 gjatë së cilit prokurorinë e përfaqësoi Znj. Alenka Sagmeister-Ranzinger, Z. Ljubomir Pantovic në cilësinë e të pandehurit dhe Z. Zeqyr Berdyna për palën e dëmtuar Zef Qetaj, dhe në praninë e të pandehurit dhe palëve të dëmtuara SMS , STS , PS , ET , Zef Qetaj dhe Krist Qetaj, më 9 nëntor 2010, u mor dhe publikisht u shpall:

AKTGJYKIMI

I pandehuri **Vukmir CVETKOVIĆ**, i biri i Dragoljub, i lindur më 12 gusht 1969 në Klinë, Pejë, më vendbanim në Boro Milotovic Nr.4, Klinë, Pejë, serb i Kosovës shpallet

FAJTOR

Sepse:

1. Më 27 apo 28 mars 1999, i pandehuri së bashku me një individ tjetër, dhe që të dy në uniformë dhe të armatosur kanë deturuar **STS** dhe familjen e tij që të largohen nga shtëpia e tyre në Klinë dhe të shkojnë në Shqipëri.

2. Më 27 apo 28 mars 1999, i veshur me uniformë, i pandehuri u ka vënë zjarrin të paktën dy shtëpive në Klinë, shtëpisë së Nue Simonaj dhe asaj të Zef dhe Krist Qetaj me flakëdhës.

PRANDAJ, i pandehuri ka kryer veprën penale krime lufte në kundërshtim me *Nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KPRSFJ)*, në kundërshtim me *Nenin 3* i përbashkët me *Konventën Katër të Gjenevës së 12 gushtit 1949 dhe Nenet 1 dhe 17 i Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë Konventave të Gjenevës 1949.*

Dhe prandaj

DËNOHET

Me burgim prej shtatë vjetësh

Në pajtim me *Nenin 73 të Kodit Penal të Kosovës (më tutje si KPK) dhe Neni 391, paragrafi 1, KPK*, koha e kaluar nën arrest dhe paraburgim do të zbritet. Vukmir Cvetkovic ka qenë 490 ditë në paraburgim në Norvegji nga 10 mars 2009 deri më 13 korrik 2010.

Në pajtim me *Nenin 102 (1), KPPK*, i pandehuri do të paguajë shpenzimet për procedurën penale.

Në pajtim me *Nenin 393 (5), KPPK*, i pandehuri mbetet në paraburgim derisa akt-gjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Lëshohet një vendim i veçant për paraburgim.

Palët e dëmtuara mund të ngritin padi për kompensim në gjykatën civile në pajtim me *Nenin 112, KPPK.*

Në pajtim me *Nenin 391 (1) (6), KPPK*, akt-gjykimi i plotfuqishëm mund të bëhet i njohur në media.

ARSYETIMI

A. PRAPAVIJA PROCEDURALE – AKTAKUZA

Vendimi mbi fillimin e hetimeve është ngritur nga Prokurori Publik më 17 shtator 2007 kundër Vukmir Cvetkovic dhe është zgjatur deri më 17 shtator 2008.

Më 4 korrik 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi urdhër-arrest kundër të pandehurit.

Më 8 korrik 2008, Zyra e Prokurorit Publik Ndërkombëtar informoi Gjykatën e Qarkut në Pejë se Vukmir Cvetkovic është gjetur në Norvegji. Prandaj, më 15 korrik 2008, gjykata e lartpërmendur nxorri një letërreshtim të brendshëm kundër tij dhe iu adresua autoritetit kompetent me kërkesën për të nxjerrë letërreshtim ndërkombëtar.

Më 21 July 2008, pasi që i pandehuri ishte në arrati, Prokurori Publik vendosi që të pezullojë hetimin.

Më 26 nëntor 2008, u nxorr urdhër-arresti si dhe urdhri i kuq nga Interpoli.

Më 13 korrik 2010, Vukmir Cvetkovic u ekstradua në Kosovë dhe u arrestua. U mbajt seanca për paraburgim në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 14 korrik 2010. U vendos paraburgimi prej një muaji.

Më 12 gusht 2010, Trupi Gjykues prej tre gjykatësve zgjati paraburgimin e të pandehurit deri më 13 tetor 2010.

Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzën më 8 shtator 2010 duke ngarkuar Vukmir Cvetkovic për krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me Nenet 22 dhe 142, KPRSFJ dhe kërkoi zgjatjen e paraburgimit. Prandaj, më 10 shtator 2010, Trupi Gjykues prej tre gjykatësve zgjati paraburgimin deri më 10 nëntor 2010, sipas Nenet 360, paragrafi 5, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Më 21 shtator, u mbajt seanca për konfirmim në prani të të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurorit. Gjykatësi për konfirmim përcaktoi se aktakuza përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe si e tillë, u konfirmua. Lënda iu dërgua Kryetarit të Trupit Gjykues.

Më 26 tetor 2010, u hap shqyrtimi kryesor dhe u përmbyll më 9 nëntor 2010.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

1. Procedura, kompetenca dhe përbërja e Trupit Gjykues në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Në pajtim me Nenin 23, paragrafi 1, KPPK gjykatat e qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me të pakten pesë vjetë burgim apo burgim afat-gjatë.

Në rastin aktual, i akuzuari është ngarkuar me veprën penale krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me Nenet 22 dhe 142, KPRSFJ, dënueshëm me 5 deri në 15 vjetë burgim¹. Prandaj, Gjykata e Qarkut në Pejë ka juridiksionin për të gjykuar lëndën në fjalë.

Sipas aktakuzës, veprat penale janë kryer në qytetin e Klinës, i cili gjendet brenda teritorit të Pejës. Prandaj, në pajtim me Nenin 27, para. 1, KPPK, Gjykata e Qarkut në Pejë ka juridiksionin territorial për të gjykuar lëndën në fjalë.

Në pajtim me Nenin 3.1 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e tyre gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, lënda e trajtuar nga PSRK-ja bie nën kompetencën primare të gjykatësve nga EULEX.

Për këtë lëndë, Trupi Gjykues është përbërë nga paneli i përbërë nga dy gjykatës nga EULEX dhe një gjykatës vendor. Asnjë nga palët nuk kundërshtoi përbërjen e Trupit Gjykues.

2. Seanca kryesore

Seancat e shqyrtimit kryesor ishin të hapura për publikun dhe u mbajtën më 26 tetor, 27 tetor, 28 tetor dhe 9 tetor 2010 në praninë e të akuzuarit (me përjashtim të mungesës së tij gjatë vend-shikimit të ngjarjes më 28 tetor 2010, për shkak se hoqi dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në këtë pjesë të procedurës, dhe ishte i përfaqësuar gjatë kësaj nga avokati i tij mbrojtës dhe me të qenë i informuar mbi rezultatet e kësaj më 9 nëntor 2010) dhe avokati i tij mbrojtës, Prokurori Publik nga EULEX, palët e dëmtuara SMS STS, Zef Qetaj dhe Krist Qetaj dhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar Zef Qetaj, Z. Zeqir Berdyna.

Në pajtim me Nenin 15, KPPK, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer gjatë gjithë procedurës gjyqësore dhe që të gjitha dokumentet relevante nga gjuha angleze në atë serbe dhe shqipe sipas nevojës.

C. PËRMBLEDHJE E PROVAVE TË PREZANTUARA

1. Gjatë shqyrtimit kryesor, dëshmitarët në vijim janë marrë në pyetje nga palët e përfshira dhe nga Trupi Gjykues:

¹ Sipas Nenit 142, KPRSFJ, kjo vepër penale është e ndëshkueshme me burgim për jo më pak se pesë vjetë apo dënim me vdekje. Dënimi me vdekje është hequr nga fuqia në Kosovë me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999. Sipas Nenit 38, KPRSFJ, korniza e përgjithshme për dënimin me burgim nuk mund të jetë më e shkurtër se 15 ditë apo më e gjatë se 15 vjetë.

- SMS i më 26 tetor 2010 dhe 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes.
- STS më 26 tetor 2010,
- ET më 27 tetor 2010 dhe 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes,
- PS më 27 tetor 2010 dhe 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes.

2. Deklaratat, raportet e policisë dhe provat e tjera dokumentuese të lexuara gjatë shqyrtimit kryesor apo që u konsideruan si të lexuara.

- Raportet e policisë
- Fotografi të shtëpive të djegura nga i pandehuri
- Fotografi të dyerve të mullirit, të bëra nga prokurori publik si dhe të sjellura nga pala e dëmtuar Zef dhe Krist Qetaj gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes në Klinë më 28 tetor 2010
- Deklarata e të pandehurit dhënë më 17 gusht 2010 në PSRK (lexuar më 27 tetor 2010)

D. RINDËRTIMI FAKTIK I NGJARJEVE

Në pjesën e mbetur të arsyetimit deklaratat e ndryshme do të prezantohen lidhur me ngjarjet më relevante për lëndën aktuale.

SMS u ftua nga prokurori dhe dha dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor më 26 tetor 2010. Ai u mor në pyetje më 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes.

Ai deklaroi se më 28 mars 1999 pasi që u dëbua nga shtëpia e tij nga forcat serbe, ai pa të pandehurin duke i vënë zjarrin shtëpisë së axhës, Ndue Simonaj sikurse edhe shtëpisë së Krist dhe Zef Qetaj. Ai ka mundur ta shohë atë në distancë prej 100 metrash dhe po mbante në kurriz një kanister me një pompë. Ai ishte i shoqëruar nga i vëllai Mishko si dhe nga katër apo pesë ushtarë të tjerë.

Dëshmitari vendosi ta raportonte Vukmir Cvetkovic në stacionin e policisë në Kline më 24 shtator 2005 pasi që e kishte parë duke u kthyer në Kline dhe duke pasur të veshur uniformën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).

Kryetari i Trupit Gjykses kishte kërkuar nga dëshmitari që të komentojë fotografinë numër 4 në dosjen e prokurorisë (faqe 59). Ai ia doli të identifikojë shtëpinë e axhës së tij në pjesën e prapme të fotografisë dhe sqaroi se shtëpia e Krist dhe Zef Qetaj ishte poashtu aty. Dy pronarët e shtëpisë kishin qenë jashtë vendit kur u dogj shtëpia. Pastaj dëshmitarit iu tregua fotografia numër 2 në dosjen e prokurorisë (faqe 57) dhe dëshmitari sqaroi se ky ishte mulliri që i pandehuri dhe disa të tjerë u përpoqën pa sukses ta digjnin. U kërku

nga dëshmitari që të shënojë fotografinë 4 faqe 59, vendin ku po qëndronte kur pa të pandehurin duke djegur dy shtëpitë.

STS u ftua nga prokurori dhe dha dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor më 26 tetor 2010.

Dëshmitari sqaroi se ai dhe familja e tij u dëbuan nga shtëpia e tyre më 27 apo 28 mars 1999 nga disa paramilitarë. Atyre u ishte thënë që të largoheshin brenda pesë minutave dhe të ecnin për në Shqipëri. Ai e kishte njohur të pandehurin që nga fëmijëria dhe e njohu si njërin nga paramilitarët në kopshtin e tij atë ditë. Kolegu i tij u kishte thënë që të largoheshin. I pandehuri kishte qenë i armatosur me Kalashnikov, por nuk ia kishte drejtuar armën dëshmitarit. I pandehuri nuk u përpoq ta mbronte. Ai konfirmoi se nuk kishte parë të pandehurin duke i vënë zjarrin asnjë shtëpie në Klinë, edhe pse kjo gjë u përmend në deklaratën e tij të datës 24 shtator 2005, pra se: "Vuleta ishte ai i cili dogji gjithë lagjen tonë dhe qytetin e Klinës". Dëshmitari tha se ishte gabim gjatë përkthimit.

Dëshmitari e raportoi të pandehurin në stacionin e policisë në Klinë kur e pa atë në uniformë të SHPK-së. Ai nuk e raportoi menjëherë pas lufte ngase ishte i zënë duke përmbushur nevojat primare të familjes së tij, pra sigurimin e ushqimit për fëmijët e tij. Dëshmitari deklaroi se i pandehuri ishte i vetmi serb kosovar i punësuar në SHPK në vitin 2005, por se nuk ishte kjo arsyeja për të cilën e raportoi atë. Por, e raportoi se vendosi së bashku me shokët dhe me familjen e tij, pasi që e dinin se çfarë kishte bërë ai gjatë luftës, që nuk ishte e drejtë që ai të vishte uniformën e SHPK-së.

PS u ftua nga prokurori dhe dha dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor më 27 tetor 2010. Ai u mor në pyetje më 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes.

Ai sqaroi duke thënë se pasi që u dëbua nga shtëpia e tij nga tre persona, ai pa Vukmir Cvetkovic dhe të tjerë duke i vënë zjarrin shtëpisë së Krist dhe Zef Qetaj dhe axhës së tij Ndue Simonaj me anë të kanisterëve. Dy shtëpitë gjenden njëra pranë tjetrës. I pandehuri kishte pasur një kanister në kurriz diku 40 - 50 të gjatë dhe e përdorte atë për të hedhur shkëndija zjarri në largësi prej 2 metrash prej shtëpive. Ai po mbante edhe një AK-47 në duar. Dëshmitari deklaroi se i kishte parë në distancë prej 40 - 50 metrash.

Dëshmitari nuk e raportoi të pandehurin pas lufte ngase kishte qenë i zënë me punë të tjera. Kur u kthye në Klinë më të përfunduar lufta, që të gjitha shtëpitë në lagje kishin qenë të djegura.

ET u ftua nga prokurori dhe dha dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor më 27 tetor 2010. Ai u mor në pyetje edhe më 28 tetor 2010 gjatë vend-shikimit të vend-ngjarjes.

Ai deklaroi se kishte parë të pandehurin së bashku me dy persona të tjerë duke djegur shtëpinë e Zef dhe Krist Qetaj. I pandehuri kishte pasur kanister në kurriz. Ai kishte të veshur një uniformë kamuflazhi nga brezi e sipër. Ky më parë ishte dëbuar nga shtëpia e tij nga tre serbë, por jo nga Vukmir Cvetkovic, edhe pse këtë të fundit e kishte përmendur

në një deklaratë të dhënë më 24 shtator 2005. Ai deklaroi se është e mundur që ka qenë një gabim në përkthim ngase i pandehuri nuk e ka dëbuar atë nga shtëpia. Kur e pa të pandehurin duke vënë zjarr, ai kishte qenë në një distancë prej 60-70 metrash. I pandehuri po digjte shtëpinë në distancë prej 1.5 metrash.

Dëshmitari deklaroi se i pandehuri u kthye në Klinë në vitin 2005 dhe ky vendosi ta raportonte atë kur e pa që sërish kishte të veshur uniformë (kësaj rradhe, atë të SHPK-së). Dëshmitari konfirmoi se pas kthimit të të pandehurit në Klinë, ai kishte pasur ca diskutime me të, por jo lidhur me çështjen e luftës. Ai e kishte vozitur vërdallë në taksinë e tij.

I pandehuri Vukmir Cvetkovic

I pandehuri deklaroi se qëndron prapa deklaratës së dhënë te prokurori publik më 17 gusht 2010 dhe se nuk dëshiron të jep tjetër dëshmi.

Më 17 gusht 2010, i pandehuri u mor në pyetje nga prokurori në praninë e avokatit të tij mbrojtës. Ai sqaroi se në mars të vitit 1999, kur filloi bombardimi nga NATO, ai kishte pasur të veshur uniformën dhe se ishte ftuar nga stacioni i policisë në Klinë ngase ishte polic rezervë. Ai e din se policia kishte pasur pajisje sikurse zjarr-hedhës.

I pandehuri kishte parë civilë duke u larguar nga Klinë, por nuk kishte parë shtëpi duke u djegur.

Në ditën kritike, kur po kthehej nga vendi i quajtur Perline, ai u ndal në qendër të Klinës ku vëzhgoi një grup personash policë dhe civilë. Ai i njohu disa nga civilët dhe u kishte thënë zyrtarëve të policisë që t'i trajtonin mirë këta ngase i ka fqinj. Madje, ai ndihmoi njërit prej fqinjëve të tij shqiptarë duke kërkuar nga policia që ta lejonte atë të merrte veturën dhe të largohej. Më tutje në qytet, ai pa edhe një grup tjetër fqinjësh që po largoheshin afër stacionit të trenit dhe i erdhi keq për ta.

Ai u kthye në Klinë në vitin 2005 dhe pa që disa nga shtëpitë e fqinjëve të tij ishin të djegura. Ai deklaroi se gjithnjë kishte pasur marrëdhënie të mira me fqinj, para si dhe pas lufte. Ai deklaroi se kishte pasur marrëdhënie të mira edhe me

STS, PS, „Zef Qetaj dhe ET”. Këta nuk i ka parë në ditën në fjalë.

Ai poashtu deklaroi se gjatë periudhës në fjalë, ai kishte pasur një AK-47.

E. VLERËSIMI I PROVAVE TË PREZANTUARA

Gjetjet faktike dhe ekzaminimi i provave

I.) Gjetjet lidhur me zhvendosjen e detyruar (dëbimin) e popullsisë civile

1.) Trupi Gjykues është i bindur se i akuzuari Vukmir Cvetkovic më 27 apo 28 mars të vitit 1999 mori pjesë si bashkë-kryerës së bashku me anëtarë të tjerë të Policisë Serbe në një operacion ushtarak në fshatin Klinë me qëllim të dëbimit të popullsisë civile shqiptare nga ky fshat duke i urdhëruar që të lirojnë shtëpitë e tyre dhe të largohen nga fshati i tyre

për shkak të planit operativ, ekzekutimin e të cilit e kishte pranuar më parë; si anëtar i njësisë së forcave serbe, i akuzuari Cvetkovic me uniformë të policisë serbe dhe i pajisur me armën automatike AK-47 në ditën kritike në një kohë të pacaktuar të ditës shkoi së bashku me së paku një bashkë-kryerës serb të pidentifikuar për të zbatuar planin e dëbimit në shtëpinë e STS dhe familjes së tij; me miratimin e Cvetkovicit, shoku i tij, i cili poashtu ishte në uniformë dhe i armatosur me Kalashnikov, i drejtoi armën dëshmitarit STS dhe i dha urdhër atij dhe familjes së tij që të lirojnë shtëpinë e tyre dhe fshatin Klinë brenda 5 minutave dhe të shkojnë në Shqipëri. Nën këtë detyrim dhe nga frika se i akuzuari dhe apo shoku i tij do të zbraznin armën në ta, STS dhe familja e tij menjëherë u nisën për në Shqipëri.

Trupi Gjykses është i bindur se i akuzuari ishte në dijeni për planin operativ serb për të dëbuar popullsinë civile shqiptare nga Klina dhe se e dinte se po vepronte në pajtim me planin kur në cilësinë e bashkë-kryerësit dëboi STS dhe familjen e tij nga fshati Klinë. Ai veproi përtej çdo dyshimi të bazuar me qëllimin në fjalë ngase ishte pjesë e forcave serbe, i pajisur me uniformë serbe, të cilën e kishte të veshur dhe një armë automatike që po e barte kur u ftua në Klinë si polic rezervë.

2.) Gjetjet nën I.1.) bazohen në deklaratën e dhënë nga dëshmitari STS, deklaratat e të cilit dhënë Trupit Gjykses është e besueshme. Trupi Gjykses ka vlerësuar mirë rezultatin e intervistimit të këtij dëshmitari dhe përcaktoi se deklaratat e tij është e besueshme, edhe pse Trupi Gjykses është i vetëdijshëm mbi papërputhshmëritë me deklaratën e tij të mëparshme kur është marrë në pyetje në një fazë të mëhershme të procedurës dhe në veçanti gjatë dëgjimit të mëparshëm të këtij dëshmitari. Është çështje e dijenisë së përgjithshme se aftësia e të mbajturit në mend gradualisht zvogëlohet dhe se elementet e intervistës, ato të rëndësishme më të vogël shpesh ndryshojnë kur merret në pyetje dëshmitari shpesh për temën e njëjtë. Përpos kësaj, duhet të jetë e kuptueshme për të gjithë se zakonisht dëshmitari do të jetë më pak i vetëdijshëm për detale pas kalimit të një periudhe dhjetë vjeçare prej kryerjes së veprës. Është e ditur në përgjithësi se zakonisht deklaratat e para që bëhen pas kryerjes së veprës penale konsiderohen si më të besueshmet ngase është atëherë kur kujtesa e dëshmitarit është më e freskët. Veçantia e krahasimit të deklaratave të dëshmitarit STS përbëhet nga fakti se deklaratat e tij e mëparshme ka qenë më fajësuese ngase dëshmitari kishte përshkruar të akuzuarin si bashkë-kryerës më aktiv duke pretenduar se ai i kishte drejtuar armën dëshmitarit dhe kishte qenë ai që kishte folur gjatë gjithë kohës. Flet në favor të besueshmërisë së dëshmitarit fakti që tani ai fajësoi të akuzuarin në një mënyrë më të lehtë se sa më parë. Pas një periudhe prej më shumë se dhjetë vjetësh, dëshmitari raportoi vetëm ato fakte që i kishte të pranishme në kujtesën e tij. Dhe fakti thelbësor i deklaratës së tij ishte se i akuzuari si anëtar i forcave serbe së bashku me dikënd tjetër kryen veprën penale të dëbimit të civilëve shqiptarë. Trupi Gjykses është i bindur se dëshmitari vërtetë raportoi veprën penale të dëbimit të kryer nga i pandehuri edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë për të raportuar për herë të parë ngjarjen penale në polici.

Është e kuptueshme që dëshmitari nuk ka ngritur padi kundër të pandehurit gjatë periudhës së mungesës së tij pas konfliktit të armatosur në Kosovë. Fajësimi i dikujt, vendndodhja e të cilit nuk dihet, nuk ka mundur të duket shumë e logjikshme për

dëshmitarin **STS** gjatë periudhës në fjalë. Dhe pas kthimit të të pandehurit në Klinë, dëshmitari informoi policinë lidhur me veprat penale që ka kryer i pandehuri.

Nuk ka ndonjë indikacion që dëshmitari ka fajësuar të pandehurin gabimisht apo paarsyeshëm. Trupi Gjykses i falë besimin atij dhe është i bindur se ai ka treguar të vërtetën kur është intervistuar nga Gjykata më 26 tetor 2010.

Trupi Gjykses është i bindur që dëshmitari **STS** nuk ka dhënë dëshmi të rreme qëllimisht. Nuk ka indikacione të dhënies së qëllim të dëshmisë së rreme nga ana e këtij dëshmitari ngase këta kanë mbajtur marrëdhënie miqësore si fqinj deri në ditën kritike dhe nuk kishte tensione ndërmjet tyre për arsye të etnisë.

Sa i përket ndërlidhjes kronologjike të raportit të parë fajësues për të dyshuarin në polici dhe shërbimin e të akuzuarit dhënë në Policinë e Kosovës, Trupi Gjykses ka marrë në konsideratë mundësinë që dëshmitari ka mundur të japë dëshmi të rreme me motivimin e tij për të shmangur apo sjellur përfundimin e shërbimeve të të akuzuarit – duke qenë ky serb – në SHKP me çdo kusht, madje edhe me çmimin e dëshmisë së paarsyeshme.

Trupi Gjykses mohon këtë mundësi, me të cilën është ballafaquar **STS**. Ai në mënyrë të qartë ka mohuar të ketë vepruar me qëllim të tillë të paligjshëm. Madje, në mënyrë të arsyeshme dhe bindëse ka sqaruar sa të patolerueshëm e ka pasur faktin se një person shërben si polic kur ky njeri ka kryer veprë penale mjaft të rëndë, pavarësisht nga etnia e tij. Trupi Gjykses i beson kësaj deklaratë të të akuzuarit dhe është i bindur se ai desh të përjashtojë të akuzuarin si zyrtar të SHPK-së për shkak të veprimeve të tij të mëparshme kriminale dhe jo për shkak të etnisë së tij. Madje as vetë i akuzuari nuk pretendoi se dëshmitari kishte motivim të tillë të paligjshëm.

Trupi Gjykses ka përjashtuar edhe mundësinë që dëshmitari ka dhënë dëshmi të gabuar për shkak të neglizhencës. *Gabimi në person* është absolutisht joreal ngase dëshmitari **STS** dhe i akuzuari njihnin njëri-tjetrin që nga fëmijëria. Sa i përket këtij fakti dhe për shkak të mungesës së indikacioneve që mund të ketë ndodhur ndonjë gabim gjatë identifikimit të kryerësit, Trupi Gjykses mohon që dëshmitari ka gabuar.

As fakti se dëshmitari raportoi të pandehurin vite pas kryerjes së veprës penale nuk krijon bazën për të dyshuar në korrektësinë e dëshmisë së dëshmitarit. Është e lehtë të kuptohet se në vitet e para pas përfundimit të luftës/konfliktit të armatosur, dëshmitari ka qenë tepër i zënë duke riorganizuar kushtet e jetesës për familjen e tij e prandaj nuk ka raportuar veprat penale që janë kryer gjatë periudhës të cilin ai më me dëshirë nuk do ta kuptonte fare ngase ai dhe familja e tij kishin vuajtur dhe ishin bërë viktime edhe pse asnjë nga familja e Simon Tunë Simonajt nuk është vrarë dhe nuk ka pësuar lëndime trupore nga i akuzuari. I pandehuri ishte larguar nga Klina për disa vjetë dhe dëshmitari nuk e ka ditur se ku ka jetuar ai kur nuk ka qenë aty. Pasi që dëshmitari nuk ka mundur ta pret që të kthehet ai në Klinë, është e kuptueshme që ai nuk ka raportuar një kryerës pa adresë të ditur.

Është gjithashtu e lehtë për të kuptuar se dëshmitarit iu kujtua e kaluara kur papritur pa të pandehurin, pas disa vjetësh nga mungesa e tij, në fshatin Klinë. Për më tepër është e kuptueshme se sa i papranueshëm ishte për dëshmitarin fakti person i cili kishte kryer një krim të rëndë disa vjet më parë aty, tani ishte në të njëjtin fshat zyrtar i policisë. Edhe

Trupi Gjykues e kupton shumë mirë se dëshmitari nuk ka raportuar menjëherë pasi e kishte parë atë sërish në fshatin e tij duke marrë parasysh se ai do të raportonte mbi kryerësin i cili ishte tashmë zyrtar policie. Të raportosh në SHPK-ë kundër një zyrtari të SHPK-së nuk është një vendim i cili merret shumë lehtë dhe një gjë e tillë kërkoi shumë kohë gjatë të cilës dëshmitari diskutoi me anëtarët e tjerë të familjes dhe rezultati ishte se i pandehuri ishte tashmë disa muaj anëtar i Policisë së Kosovës deri ditën kur ai u raportua për krimin në fjalë.

Për më tepër edhe deklaratat e dhënë nga i pandehuri nuk dha asnjë shkas për të dyshuar nëse dëshmitari **STS** kishte dëshmuar mbi të vërtetën. I pandehuri ka pretenduar vetëm se ishte i pafajshëm dhe se nuk ka kryer veprë penale; ai nuk ishte i gatshëm të jepte ndonjë deklaratë të mëtejshme apo t'i përgjigjej pyetjeve të Trupit Gjykues. Është e drejta e padiskutueshme e të pandehurit që të mbrohet në këtë mënyrë. Por thjesht mohimi i fajësisë apo pretendimi nga i pandehuri se nuk ka kryer veprë penale dhe mospasja e asnjë pretendimi se dëshmia e dëshmitarit **STS** është pasojë e ndonjë gabimi apo e ndonjë qëllimi të veçantë mund të kualifikohen si përpjekje të dëshpëruara për t'iu shmangur përgjegjësisë së tij penale dhe nuk ngrenë ndonjë dyshim të bazuar mbi atë që kishte thënë dëshmitari.

II.) Rezultatet përse i përket vënies së zjarrit të të paktën dy shtëpive

1) Për më tepër, Trupi Gjykues është i bindur se i akuzuari Vukmir Cvetkovic më datë 27 ose 28 mars 1999 duke qenë i veshur me uniformë serbe ka marrë pjesë në një operacion ushtarak të planifikuar dhe të organizuar me anëtarë të tjerë të Forcave Serbe me qëllim që të dëbojë civilët shqiptarë nga fshati Klinë/Klina duke i vënë zjarrin të paktën shtëpisë së Nue Simonaj dhe asaj të Zef dhe Christ Qetajt duke përdorur një flakëdhënëse.

2) Gjetjet nën II.1) bazohen së pari mbi deklaratat e dëshmitarëve **SMS** dhe **PS** të cilët kanë dëshmuar më parë para Gjykatës duke thënë se ata e kanë parë të akuzuarin duke i vënë zjarrin dy shtëpive të Ndue Simonaj dhe Krist dhe Zef Qetajt dhe deklaratën e **ET** i cili ka dëshmuar se ka parë të akuzuarin duke i vënë zjarrin shtëpisë së Krist dhe Zef Qetajt.

Trupi Gjykues është i bindur se të tre këta dëshmitarë kanë thënë atë që kanë parë me sytë e tyre dhe atë që ka ndodhur në të vërtetë dhe se të gjithë ata kanë thënë të vërtetën mbi këtë.

Përse i përket devijimeve të deklarataveve të tyre gjasat për këtë janë spjeguar njëherë në lidhje me vlerësimin e deklaratës së dëshmitarit **STS**. E njëjta gjë vlen për dëshmitë e tre dëshmitarëve të lartpërmendur të cilët kanë dëshmuar mbi vënien e zjarrit shtëpive. Të gjitha do t'a kuptojnë se raporte të ndryshme gojore mbi një ngjarje e cila ka ndodhur më shumë se 10 vjet më parë ndryshojnë nga njëra tjetra. Përse i përket vënies së zjarrit shtëpive nga i akuzuari, ka ndryshime mes deklaratave të dëshmitarëve **SMS**, **PS** dhe **ET** krahasuar me deklaratat e tyre të mëparshme dhe gjithashtu mes deklaratave të dëshmitarëve. Kjo nuk është e papritur meqenëse për shembull dëshmitari **SMS** ka dëshmuar tashmë pesë herë mbi ngjarjet e marsit 1999 para shqyrtimit kryesor, dhe këto deklarata janë siç vijojnë:

- deklaratë dhënë policisë së UNMIK-ut më datë 24 shtator 2005
- deklaratë dhënë njësisë së Krimeve të Luftës të UNMIK-ut më datë 16 dhjetor 2006
- deklaratë dhënë njësisë së Krimeve të Luftës të UNMIK-ut më datë 16 shkurt 2007
- deklaratë dhënë njësisë së Krimeve të Luftës të UNMIK-ut më datë 9 maj 2008
- deklarata dhënë PSRK-së më datë 9 gusht 2010

Dhe, gjatë shqyrtimit kryesor ai është marrë në pyetje mbi të njëjtën ngjarje edhe dy herë të tjera, në seancën e gjyqimit në gjykatë më datë 26 tetor 2010 dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më datë 28 tetor 2010. Do të ishte mëse e dyshimtë dhe e papritur nëse nuk do të kishte disa variante të ndryshme në deklaratat e mëvonshme krahasuar me ato të mëparshmet. Devijimet ishin të një natyre më pak të rëndësishme dhe ndryshime të vogla janë normale për shkak të kohës që ka kaluar dhe për shkak të numrit të intervistave.

Përsa i përket pjesës thelbësore të deklaratave të dëshmitarëve, vënia e zjarrit të shtëpive, nuk ka devijime të rëndësishme në atë që ata kanë thënë para Trupit Gjykues në krahasim me deklaratat e tyre të mëparshme. Kjo qëndrueshmëri i demonstroi gjykatës se këta tre dëshmitarë kanë thënë të vërtetën. Për më tepër përdorimi i flakëdhëses është provuar nga deklarata e mëtejshme e dëshmitarit se i akuzuari ka tentuar t'i vërë zjarrin edhe derës së drunjto të mullirit në Klinë/Klina me flakëdhësen që kishte; Trupi Gjykues vërejti gjatë inspektimit të vendngjarjes shenjat e bëra në atë derë dhe i referohet fotografisë korresponduese të marrë nga Prokurori Publik në vendngjarje, shih shtojcën bashkangjitur procesverbalit lidhur me inspektimin e vendngjarjes. Edhe për një person jo profesionist, është e qartë se dikush ka tentuar t'i vërë zjarrin derës së rëndë së hyrjes të mullirit të vogël në Klinë/Klina por se dera ka rezistuar deri sa tentativa ka përfunduar, gjë e cila ka ndodhur pas një kohe të shkurtër pas përdorimit të flakëdhëses.

Përmes kësaj besueshmëria e tre dëshmitarëve të lartpërmendur mbështetet nga një fakt i vërtetuar, përdorimi dhe efikasiteti i mjetit të përdorur nga i akuzuari sipas deklaratave të këtyre dëshmitarëve.

Përsa i përket pretendimit të të pandehurit se nuk kishte njohuri nëse policia serbe ishte e pajisur me flakëdhëse, ky aspekt nuk përbën ndonjë shkak për të shkaktuar ndonjë dyshim në besueshmërinë e dëshmitarëve SMS, PS dhe ET. Nuk ka rëndësi nëse policia serbe ishte rregullisht e pajisur me këto mjete apo nëse ata kanë përdorur pajisje ushtarake kur kanë vepruar bashkë, dhe kjo për arsye se Trupi Gjykues e di me siguri se forcat ushtarake serbe kanë qenë të pajisura me flakëdhëse.

Në lidhje me dy çështjet të cilat mund të kenë shkaktuar dyshime, nga njëra anë periudha kohore që ka kaluar pas ngjarjes kritike deri kur tre dëshmitarët e lartpërmendur kanë raportuar se i pandehuri u kishte vënë zjarrin shtëpive, dhe nga ana tjetër pyetja nëse një prej dëshmitarëve ka raportuar në polici me qëllimin e vetëm për të shmangur një zyrtar policie serb në Klinë/Klina, këto aspekte u spjeguan më lart në lidhje me dëshmitarin STS dhe të njëjtat argumente janë të vlefshme edhe për deklaratat e tre

dëshmitarëve të tjerë me përfundimin se Trupi Gjykses është i bindur se ata kanë dëshmuar të vërtetën.

Edhe në lidhje me dëshmitarët SMS, PS dhe ET Trupi Gjykses është i bindur se ata nuk kanë dëshmuar gabimisht se i akuzuari ishte një prej bashkë-kryerësve të cilët u vunë zjarrin shtëpive përkatëse. Ashtu si dëshmitari STS edhe ata e njihnin të pandehurin shumë mirë prej një kohe të gjatë dhe Trupi Gjykses është i bindur se të gjithë dëshmitarët kanë identifikuar saktë personin i cili ka qenë duke ndërmarrë këto veprime. Fakti se Trupi Gjykses është i sigurt në këtë drejtim mbështetet gjithashtu nga gjetjet gjatë inspektimit të vendngjarjes. Është përtej çdo dyshimi se dëshmitarët kanë bërë identifikimin e saktë nga vendi ku ishin duke vëzhguar të pandehurin i cili po përdorte flakëhedhësen mbi ato objekte. Gjithashtu nuk ka dyshime se aty nuk kishte asnjë pengesë përse i përket pamjes, si largësia, pemë apo ndërtesa; edhe drita natyrale gjatë kohës së drekës ishte e mirë.

Gjithashtu në lidhje me vënien e zjarrit të shtëpive të gjitha kushtet subjektive janë përmbushur. Plani operacional serb që të dëbonte shtetasit civilë shqiptarë nga Klinë/Klina përfshinte edhe vënien e zjarrit shtëpive të tyre. I akuzuari e dinte atë dhe ai veproi përkatësisht që të zbatonte planin. Ai kishte veshur uniformën serbe, ai veproi së bashku me anëtarë të tjerë të forcave serbe dhe përdori një flakëhedhëse me të cilën ishte pajisur me qëllim që t'i vinte zjarrin shtëpive të shtetasve shqiptarë. Ai veproi plotësisht në mënyrë të qëllimshme.

Nuk ka asnjë të dhënë se në atë kohë përgjegjësia penale e të akuzuarit ishte e e kufizuar.

F. KUALIFIKIMI LIGJOR

Jurisprudenca e vazhdueshme gjatë gjithë këtyre viteve, mbi Krimet e Luftës, ka vendosur, cilat janë elementët të cilat duhet të përmbushen për të gjetur përgjegjësinë penale të të akuzuarit; në veçanti duhet të vërtetohet së paku si në vijim:

- ekzistenca e një konflikti të brendshëm të armatosur dhe natyra detyruese e aplikimit të ligjit ndërkombëtar mbi palët;
- pjesëmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur;
- një lidhje mes krimit të pretenduar dhe konfliktit të armatosur;
- statuti civil (i mbrojtur) i viktimës;
- shkelja edhe e ligjit të brendshëm dhe e atij ndërkombëtar;
- pjesëmarrja e të akuzuarit në veprat penale.

Ekzistenca e një konflikti të brendshëm të armatosur dhe natyra detyruese e ligjit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar të aplikueshëm mbi palët;

Një konflikt i armatosur ekziston në çdo lloj kohe kur ekziston përdorimi i dhunës së armatosur mes shteteve apo në rastin e një dhune të armatosur të zgjatur mes

autoriteteve shtetwrore dhe grupeve të organizuara të armatosura. Ligji ndërkombëtar humanitar (LNH) është i aplikueshëm nga fillimi i një konflikti të tillë dhe shkon përtej pushimit të veprimeve ushtarake derisa arrihet një marrëveshje paqe e përgjithshme.

Në pajtim me *Nenin 3 të Konventave të Gjenevës*, kriteri thelbësor që një konflikt i brendshëm i armatosur të konsiderohet si i tillë është që dhuna e armatosur e zgjatur të ndodhë mes autoriteteve të shtetit dhe grupeve të organizuara të armatosura ose mes grupeve të tilla brenda një Shteti. Protokollin Shtesë II i vitit 1977 plotëson këtë të fundit duke përcaktuar se këto grupe duhet të jenë nën një komandë të përgjegjshme dhe të ushtrorë një kontroll të caktuar në një pjesë të territorit të Shtetit, kontrolli i cili u jep mundësinë që të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të përbashkëta dhe që veprimet luftarake të shkojnë përtej atyre të përcaktuara vetëm si situata të çregullimeve dhe tensioneve të brendshme siç janë për shembull trazirat, veprat sporadike dhe të izoluar të dhunës ose vepra të tjera të natyrës së ngjashme.

Është fakt shumë i njohur² se, në mars 1999, kishte një konflikt të brendshëm të armatosur në Kosovë mes forcave jugosllave/serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), i cili mund të konsiderohet si një konflikt i brendshëm parashikuar nga Neni i Përbashkët i Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II të vitit 1977.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur

Është e qartë se i pandehuri ka marrë pjesë në konfliktin e armatosur duke qenë pjesë e forcave serbe dhe duke qenë aktiv në Klinë/Klina në mars 1999. Kjo është vërtetuar nga fakti se gjatë ditëve kritike i pandehuri ka pasur të veshur uniformën e policisë serbe.

Lidhje mes krimit të pretenduar dhe konfliktit të armatosur

Konflikti i armatosur ka luajtur një rol themelor në aftësinë e të pandehurit për të kryer veprat penale. Dhe është e vërtetë se i pandehuri ishte i armatosur dhe në pozitë të kryente veprat penale të lartpërmendur duke qenë pjesë e forcave serbe. Veprat penale u kryen gjatë konfliktit të armatosur dhe ishin pjesë e një plani të përgjithshëm për të zhvendosur popullsinë shqiptare civile nga zona.

Statuti civil (i mbrojtur) i viktimës

Neni 142 i KPRFSJ-së kërkon shprehimisht që viktima të jetë pjesë e popullsisë civile. Në rastin e konfliktit të brendshëm, Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe Protokollin Plotësues II të vitit 1977 mbrojnë të gjithë personat të cilët nuk janë luftëtarë dhe të cilët nuk marrin pjesë direkt në luftime. Një civil përkufizohet si dikush i cili nuk merr pjesë në mënyrë aktive gjatë veprimeve ushtarake me qëllim që t'i shkaktojë dëmtim fizik personelit të armikut apo objekteve.

Neni 5 i Konventës IV të Gjenevës parasheh se një civil e humb statutin e tij/saj si person i mbrojtur kur "dyshohet qartësisht për ... aktivitete armiqësore për sigurinë e Shtetit ..."

² Aktgjykim TPNJ në lëndën *Milutinović et al*, IT-05-87, I datës 26 shkurt 2009, faqe 324.

Trupi Gjykses gjen se nuk ka prova se pala e dëmtuar në këtë rast ka qenë palë luftuese dhe se kjo palë nuk ka marrë pjesë direkt gjatë luftimeve. Pala e dëmtuar në këtë rast duhet të konsiderohet si civile.

Shkelja e ligjit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar:

Trupi Gjykses pajtohet me faktin se gjatë kohës së kryerjes së veprave penale ishin të aplikueshëm KPRFSJ-së si dhe Konventat e Gjenevës së datës 12 gusht 1949 dhe Protokollit Plotësues i datës 8 qershor 1977. Dhe në fakt, Jugosllavia ka nënshkruar Konventat e Gjenevës më datë ...

Neni i Përbashkët 3 i katër Konventave të Gjenevës parasheh se *“personat të cilët nuk marrin pjesë në mënyrë aktive gjatë veprimeve luftarake, përfshirë anëtarët e forcave të armatosura të cilët kanë ulur dhe ata jashtë luftimeve për shkak të sëmundjeve, plagëve, burgosje apo nga ndonjë shkak tjetër do të trajtohen në mënyrë humane në të gjitha rrethanat, pa asnjë lloj dallimi armiqësor race, ngjyre, feje apo besimi, gjinie, prejardhje apo pasurie apo ndonjë kriter të ngjashëm.*

Për këtë qëllim, veprimet e mëposhtme janë dhe vazhdojnë të jenë të ndaluara në çdo lloj kohe dhe vendi në lidhje me personat e lartpërmendur:

(a) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

(b) marrja e pengjeve;

(c) kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues;

(d) shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat njihen në përgjithësi si të domosdoshme.”

Përsa i përket dëbimit, duhet të merret në konsideratë Neni 17 i Protokollit Plotësues II i datës 8 qershor 1977 i katër Konventave të Gjenevës së datës 12 gusht 1949 mbi Ndalimin e zhvendosjes së detyruar të civilëve. Aty thuhet se:

“1. Zhvendosja e popullsisë civile nuk urdhërohet për arsye që kanë lidhje me konfliktin përveç rasteve kur është në fjalë siguria e civilëve apo kur një gjë e tillë kërkohet nga arsye imperative ushtarake. Nëse zhvendosja duhet të bëhet atëherë duhet të merren të gjitha masat e mundshme me qëllim që popullsia civile të strehohet në kushte të kënaqshme përsa i përket higjenës, shëndetit, sigurisë dhe ushqimit.

2. Civilët nuk detyrohen të largohen nga territori i tyre për arsye që lidhen me konfliktin.”

Në pajtim me nenin 142 të KPRFSJ-së, mes veprimeve të tjera, konsideron si krime lufte kundër popullsisë civile: “zhvendosjen apo rivendosjen apo deportimin me dhunë” të civilëve.

Në lidhjen me vënien e zjarrit të shtëpive, Neni 142 i KPRFSJ-së duhet të konsiderohet si reference e “plaçkitjes së pronës së popullsisë” e cila duhet të konsiderohet si krim lufte kundër popullsisë civile.

Prokurori publik ka sqaruar gjithashtu se vepra penale e ndëshkueshme me ligjin e aplikueshëm të KPRFSJ-së është vepër penale e parashikuar edhe nga ligji aktual (Kodi Penal i Kosovës) Neni 121 (2) lidhur me Nenin Article 23. Dënimi për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile është më i ashpër nëse zbatohet ligji aktual dhe për këtë arsye Trupit Gjykoës iu desh të aplikonte ligjet e lartpërmendura. Krimi në fjalë nën ligjin aktual do të ndëshkohej më ashpër për arsye se Neni 121 (2) (8) i KPK-së i cili i referohet zhvendosjes së popullsisë civile parasheh një periudhë prej të paktën 10 vjet ose nurgim afatgjatë, nga 21 deri 40 vjet, në pajtim me Nenin 37 (2), KPK-ës.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në veprat penale.

Trupi Gjykoës gjen përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprat penale krime lufte kundër popullsisë civile duke dëbuar një familje dhe duke i vënë zjarrit të paktën dy shtëpive.

G. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Gjatë vendosjes së dënimit penal Trupi Gjykoës duhet të marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – i cili është që të eliminojë aktivitetet të rrezikshme shoqërore duke dekurajuar personat e tjerë për të kryer vepra të ngjashme penale– dhe qëllimin e veçantë, i cili është të parandalojë kryerjen e veprave të tjera penale nga kryerësi.

Trupi Gjykoës ka marrë në konsideratë të gjitha faktorët pro dhe kundër me qëllim që të gjejë një ndëshkim të drejtë dhe të ekuilibruar dhe gjatë këtij procesi konsideroi në veçanti aspektet si në vijim:

Në favor të të pandehurit duhet të konsideroheshin

- a) se i pandehuri nuk ka dënim të mëparshëm megjithëse në fakt nuk pritet që kryerësi i cili është zyrtar policie të ketë precedentë penal,
- b) se i pandehuri është i shkolluar dhe i shoqërueshëm, ai është i martuar dhe ka një djalë gjashtë vjeçar i cili varet nga ai, dhe gjendja ekonomike e të akuzuarit dhe familjes së tij është e varfër,
- c) fakti se ai jeton i ndarë nga familja e tij, e cila jeton në Serbi, shkakton një barrë shtesë për të për shkak të vështirësive që anëtarët e familjes së tij hasin për t’a vizituar në Kosovë,
- d) periudha e gjatë kohore që ka kaluar që nga koha e kryerjes së krimit– shih Nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut -, megjithëse kjo rrethanë lehtësuese nuk

është plotësisht e aplikueshme për shkak se një pjesë e periudhës kohore është shkaktuar nga ikja e të pandehurit derisa është arrestuar në Norvegji,

e) si përfundim edhe fakti se kryerja e këtij krimi dhe pesha e tij në krahasim me krime të tjera të kësaj natyre, ishte e një niveli mesatar duke patur parasysh se asnjë nga viktimat nuk është vrarë ose nuk ka pësuar lëndime fizike.

Faktorët e mëposhtëm duhet të merreshin në konsideratë si kundër të pandehurit

a) fakti se i pandehuri ka kryer krime lufte, ka marrë pjesë në dëbimin e popullsisë civile shqiptare, në dy mënyra, nga njëra anë si bashkëkryerës dhe nga ana tjetër duke u vënë zjarrin shtëpive,

b) fakti se i pandehuri i ka vënë zjarrin jo një shtëpie por dy shtëpive,

c) fakti se i pandehuri, duke u vënë zjarrin shtëpive, ka shkaktuar rrezik serioz për shtëpitë fqinje dhe popullsisë së Klinës/Klina duke kërcënuar jetët e tyre.

H. SHPENZIMET

Meqënëse i akuzuari Vukmir Cvetkovic u shpall fajtor; ai duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale me përjashtime të shpenzimeve të përkthimit (KPPK, Neni 102, Paragrafi 1). Trupi Gjykes do të nxjerrë një vendim të veçantë mbi shumën e shpenzimeve kur të sigurohen të dhënat.

I. KËRKESË PËR DËMSHPËRBLIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor palët e dëmtuara janë informuar edhe njëherë mbi mundësinë që kanë për të ngritur një kërkesë për dëmshpërblim në kuadër të procedurës penale, në pajtim me Nenin 355, Par. 2, KPPK. Ata informuan Trupin Gjykes se një kërkesë të tillë do t'a ngrenë përmes një procedure civile.

Për këtë arsye Trupit Gjykes nuk iu desh që të merrte një vendim të tillë.

Nëntë nëntor 2010.

Gjykatës Ingo Risch
Kryetar i Trupit Gjykes

Gunnar Øyhaugen
Anëtar i Trupit Gjykses

Salih Berisha
Anëtar i Trupit Gjykses

Robina Struthers
Procesmbajtëse

MJET LIGJOR: Në pajtim me Nenin 400, KPPK, ankesa duhet të lajmërohet brenda tetë (8) ditëve pas shpalljes së aktgjykimit dhe në pajtim me Nenin 398(1) KPPK, personi i autorizuar mund të ngrejë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur ka marrë në dorëzim kopjen e këtij aktgjykimi.